



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika c) dhe nenit 17 pika f) të Ligjit nr.06/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 15 dhe 34 të Ligjit nr.04/L-060 për mbeturinat ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.17/2012), Ligjit nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-060 për mbeturinat ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.29/2022), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e tetë të rregullt, e mbajtur më datën 26.12.2023, merr këtë:

Rregullore nr.01/2023/KG për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.02/2021/KG (Nr.1551/21 e datës 07.04.2021) për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Graçanicës

Neni 1

Neni 9 paragrafi 2 i Rregullores nr.02/2021/KG (Nr.1551/21 e datës 07.04.2021) ndryshon si në vijim:

2. Për shkelësit e dispozitave të kësaj Rregulloreje, për veprime të ndaluara, neni 8 (paragraf 1-17), inspektori komunal, polici, shqipton dënime mandatore monetare në përputhje me dënimet e përcaktuara me Ligjin nr.04/L-060 për mbeturinat dhe Ligjin nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-060 për mbeturinat.

Neni 2

Aneksi 1 i Rregullores nr.02/2021/KG (nr.1551/21 i datës 07.04.2021) ndryshohet me Aneksin që është i bashkëgjitur me këtë Rregullore.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.



Kryesuesi i Kuvendit


Milan Dimitrijević

**Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave për personat fizikë dhe juridikë,
subjektet ekonomike, organizatat dhe institucionet në Graçanicë dhe
vendbanimet**

Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave në amvisëritë individuale dhe objektet banesore

Tabela 1.

Nr.	Kriteret e llogaritura të përdoruesit	Çmimi	TVSH 8%	Gjithsej
1.	Amvisëritë/ objektet banesore	6,02	0,48	6.5

Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave - grumbullimi i mbeturinave një herë në javë në bazë të orarit të ndryshueshëm.

Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave për subjektet ekonomike dhe institucione

Tabela 2.

Nr.	Përshkrimi dhe kriteret e llogaritura të përdoruesit	Çmimi	TVSH 8%	Gjithsej
1.	Kompensimi mujor – një shportë prej 120 l (zbrazja një herë në javë)	6,02	0,48	6,5
2.	Kompensimi mujor – një shportë prej 240l (zbrazja një herë në javë)	11,11	0,89	12
3.	Kompensimi mujor - kontejner 1 m ³ (zbrazja një herë në javë)	29,63	2,37	32
4.	Kontejner 5 m ³ sipas zbrazjes (mbeturina komunale)	32,41	2,59	35
5.	Kontejner 7 m ³ sipas zbrazjes (mbeturina komunale)	41,67	3,33	45 .

Ngarkimi dhe deponimi i mbeturinave jo të rrezikshme komunale në deponitë rajonale për ton

Tabela 3.

Nr.	Përshkrimi dhe kriteret e llogaritura të përdoruesit	Njësi matëse	Çmimi	TVSH 8%	Gjithsej
1.	Deponimi i mbeturinave të biodegradueshme (pa ngarkim)	m ³	9,26	0,74	10
2.	Deponimi i mbeturinave të biodegradueshme (me ngarkim)	m ³	18,52	1,48	20
3.	Deponimi i mbeturinave ndërtimore dhe të përziera në deponinë qendrore	t	69,44	5,56	75
4.	Deponimi i mbeturinave ndërtimore dhe të biodegradueshme në deponinë e përkohshme (pa ngarkim)	m ³	9,26	0,74	10

Grumbullimi i jashtëzakonshëm i mbeturinave

Tabela 4.

Nr.	Përshkrimi i shërbimit	Njësi matëse	Çmimi	TVSH 8%	Gjithsej
1.	Pastrimi i jashtëzakonshëm i kontejnerëve të vogël për amvisëri/biznese prej 120 litrash sipas thirrjes	kontejner	4,63	0,37	5
2.	Pastrimi i jashtëzakonshëm i kontejnerëve të vogël për amvisëri/biznese prej 240 litrash, sipas thirrjes	kontejner	9,26	0,74	10
3.	Pastrimi i jashtëzakonshëm i kontejnerëve për amvisëri/biznese prej 1.1 m ³ sipas thirrjes	kontejner	18,52	1,48	20